# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449753**

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Tragjedi në Alpet Zvicerane, tre të vdekur pas rrëzimit të një aeroplani të vogël |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/16/tragjedi-ne-alpet-zvicerane-tre-te-vdekur-pas-rrezimit-te-nje-aeroplani-te-vogel/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 15:44:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 15:41:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 15:40:00 UTC → 16 shtator 2026, 15:42:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `312b073e81c1a99239188ba9c5e31203a123df67f6fbdeff0d55790d9d881b42` |
| TEKSTI | `f3cc6958b66b5a6c4792c936ee22d33938f8e3d1c8f8dd643102d2321e819b2c` |
| PAMJA | `4d52e7c1cd744e7df1d8728e536ab631f587e477599d653446838fed0ad1156c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0883e7bd322384df79f398091130a278268aee97c1cb837f4821c212c8f391e1` |
| E MËPARSHMJA | `e528f380d06edf219da865db81f7a64bff21e1ddeccffe9ae4b0fb1775374972` |
| RRËNJA MERKLE | `6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0883e7bd322384df79f398091130a278268aee97c1cb837f4821c212c8f391e1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

# Tragjedi në Alpet Zvicerane, tre të vdekur pas rrëzimit të një aeroplani të vogël

16/09/2026 17:41




**Tre persona kanë humbur jetën pasi një avion i vogël me një motor u rrëzua në Alpet zvicerane, në jugperëndim të vendit.**

Autoritetet kanë nisur hetimet për të zbardhur shkaqet e aksidentit.

Sipas policisë kantonale të Valais, avioni u rrëzua pasditen e së martës në shpatin verior të një mali në zonën Fluchalp, pranë vendpushimit malor të Leukerbad.

Të tre personat që ndodheshin në bord humbën jetën. Autoritetet zvicerane kanë nisur procedurat për identifikimin e viktimave, ndërsa deri tani nuk janë bërë të ditura identitetet e tyre.

Avioni ishte ngritur nga Lugano, në kantonin italishtfolës të Ticinos, dhe kishte bërë një ndalesë në Sion, në kantonin e Valais.

Më pas, ai ishte nisur drejt aeroportit Buchs, në kantonin e Nidwalden, por për arsye që ende nuk dihen, u rrëzua në një zonë malore.

Përplasja ndodhi pak pas orës 16:00, sipas orës lokale. Pas aksidentit, në zonë u raportuan gjurmë tymi, ndërsa banorët vendas njoftuan shërbimet e emergjencës pasi panë tymin që ngrihej nga vendi i rrëzimit.

"Për arsye që ende nuk janë të qarta, avioni u rrëzua në shpatin verior të një mali në zonën Fluchalp të Leukerbad. Më pas u raportuan gjurmë tymi në zonë", tha policia në një deklaratë.

Forcat e shpëtimit u angazhua në vendngjarje, me pjesëmarrjen e tre helikopterëve dhe dy ekipeve të specializuara të shpëtimit.

Një fotografi e publikuar nga policia lokale tregon rrënojat e avionit të shpërndara në shpatin e malit.

Autoritetet federale zvicerane kanë hapur një hetim për të përcaktuar rrethanat dhe shkaqet e sakta të rrëzimit.

Paralelisht, po zhvillohet edhe një hetim penal nën mbikëqyrjen e Zyrës së Prokurorit Federal, në bashkëpunim me policinë kantonale të Valais.

Deri më tani, nuk është dhënë asnjë informacion për identitetin e tre viktimave dhe as për atë që i parapriu përplasjes.

**Top Channel**

## Bota »





## Kryesore



Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve
17:40

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!
11:43

Vendimi i gjykatës së Hagës, qytetarët shprehin revoltë në Prishtinë: Nuk ia vlen të jetosh kur vendi yt shkatërrohet! Dëgjohen krisma armësh
11:58

Foto/ Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së
13:21

"UÇK nuk është vetëm një emër në histori"/ Sulmuesi i Kombëtares shqiptare reagon pas vendimit të marrë në Hagë
13:49

## Më të lexuarat

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve

"A ka rrezik të vdesë në burg?"/ Milaim Zeka shpërthen në lot, tregon komentin e vajzës për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

Gjykata speciale në Hagë dënon me 81 vite në total për ish-liderët e UÇK, protestë masive në Prishtinë

Nuk kënaqet me 81 vite burg për ish-krerët e UÇK, Prokurorja e Specializuar e Hagës: Do kërkojmë në Apel dënim edhe për krimet kundër njerëzimit

Seanca për ish-krerët e UÇK-së në Hagë, gjykata dënon me 25 vite burg Hashim Thaçin

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

"U vërtetua arrestimi i paligjshëm i së paku 385 personave"/ Trupi gjykues: Të ndaluarit u rrahën dhe iu shkaktuan vuajtje psikologjike

Nuk mund të luajë më me Shqipërinë, sulmuesi i talentuar grumbullohet nga

Jurgen Klopp

Burg për ish-krerët e UÇK-së, Milaim Zeka: E dija që para 3 ditësh se do kishte vendim të rëndë, ja sinjalet

Dënimet individuale për katër ish-liderët e UÇK, çfarë pritet të ndodhë më pas



Alarm në Britani/ 3-vjeçari zhduket nga këndi i lojërave, policia dhe mbi 1,000 vullnetarë në kërkim të Noah

16/09 16:47



Shembet miniera e arit në Sudan/ Të paktën 60 të vdekur, shumë të tjerë ende të bllokuar

16/09 16:34



Nipi i Princeshës Katerina gjendet i vdekur në shtëpinë e tij në Londër, ishte i dyshuar në çështjen “Putney Pusher”

16/09 16:27



Bonnie Greer, shkrimtarja britaniko-amerikane, ndahet nga jeta në moshën 77-vjeçare

16/09 16:18



Kanadaja kërkon të ulë varësinë nga SHBA, BE i hap derën për një rol të ri, von der Leyen propozon anëtarësimin e parë të asociuar

16/09 14:33



Dronët rusë u shfaqën pranë avionit të Zelenskyt në Moldavi, presidenti ukrainas: Mendoj se e dinin që isha atje

16/09 09:52

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News- Drejtësia kundër projektligjit për pagat! GJL i drejtohet Kuvendit: Mos e miratoni!



Top Channel/ Vendimi për liderët e UÇK, protestuesit gjuajnë me gurë godinën qeveritare në Prishtinë



Top News – 40 mijë bomba njëtonëshe në Izrael / Trump ‘ndryshon mendje’, 2.8 miliardë USD armatime



Top News – Të ndalim garën e armatimit në hapësirë! Rusia paqebërëse, apel SHBA-së: Ka ende kohë



Top News – ‘Padrejtësi e papranueshme’. Kurti reagon pas dënimit të 4 krerëve të UÇK



Top News – ‘Specialja’ e blinduar në Kushtetutë. Misioni i pamundur për të shkrirë gjykatën e Hagës



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.